

AKT THEMELIMI
I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar
“ZOI” SH.P.K.

Sot, me 15/06/2022, i nenshkruari:

Xhovana Hasani, ne cilesine e ortakut te vetem te **“ZOI” SH.P.K.** i bija e Nikolin Hasanit , lindur me 11.07.1996, ne Tirane me shtetesi Shqiptare, mbajtes i kartes indentitetit me nr. J65711059B, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar

Neni 1

Personi i siperpermendur, me vullnetin e tij te lire dhe te plote dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi, vendosi te krijojë Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emertimin **“ZOI” Sh.P.K.**, me kapital themeltar 10.000 (dhjete mije) lek.

Selia e shoqerise do te jete ne Tirane, Rr.Peti , Liqeni Thate.

Shoqeria **“ZOI” SH.P.K.**, ka te drejte te krijojë filiale brenda dhe jashte Shqiperise, ne menytrat dhe me kohezgjatje ashtu sikunder e konsideron te arsyeshme, dhe me miratimin e organeve kompetente.

Neni 2

Kompania gezon statusin e personit juridik.

Aktivitetet e saj do te kryhen sipas dispozitave te ketij akti, statutit dhe legjislacionit aktual. Statuti i kompanise eshte i bashkelidhur ketij akti te themelimit dhe formon nje pjese integrale me te.

Neni 3

Veprimtaria e kompanise si nje entitet juridik fillon me miratimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te jete e vlefshme per nje periudhe te pacaktuar kohe. Shoqeria perfundon aktivitetet e veta me vendimarrje unanime nga te gjitha ortakët e saj.

Neni 4

Shoqeria ka si objekt kryesor: Tregtim dhe prodhim inertesh, tregtim betoni, tregtim hekuri, transport mallrash te ndryshem, shpim pilotash hapje themelesh, ndertim godina banimi civile dhe industriale, tregtim te gjitha materialeve ndertimore, hidraulike elektrike, mure mbajtese dhe rikonstruksione.

Neni 5

Kapitali fillestar i kompanise do te jete 10.000 (dhjete mije) leke te cilat mbeten prone e pronarit.

Xhovana Hasani 1 Kuote me 10 000 leke secila.

Kapitali themelor eshte depozituar nga aksionaret ne emer te shoqerise. Aktiviteti i shoqerise do te rregullohet, pervec ketij akti themelimi, me normat e vendosura ne Statut, kundrejt nenshkrimit te ortakut, dhe aprovimit nga Qendra Kombetare e Regjistrimit, diten qe do te marre cilesine e personit juridik.

Neni 6

Shoqeria do te kete Administrator te saj, Znj.Xhovana Hasani i bija e Nikolin Hasanit , lindur me 11.07.1996, ne Tirane, mbajtes i kartes indetitetit me nr. J65711059B,madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe ligji ua jep shprehimisht ortakeve.

Administratori ka te drejte te caktoje nje apo me shume perfaqesues te tij qe te mund te kryejne deri te njejtat funksione si administratori pa asnje limit, me prokure apo me autorizim, sipas ligjit.

Neni 7

Fitimi neto qe do te realizohet nga aktivitetet e kompanise do te ndahet midis ortakeve ne perpjesetim me aksionet e tyre ne kompani. Çdo anetar eshte i lire per te marre pjesen e vet te fitimeve ne nje llogari bankare brenda apo jashte shtetit Shqiptar.

Neni 8

Per borxhet qe mund te ezistojne ne te ardhmen ndaj paleve te treta gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet vetem me kapitalin e saj themeltar. Anetaret nuk jane pergjegjes per borxhet e shoqerise me pronen e tyre.

Neni 9

Anetaret jane te detyruar per te ruajtur natyren konfidenciale te aktivitetit te shoqerise.

Neni 10

Marredheniet e punes ne shoqeri apo deget e saj rregullohen me kontraten e punes ne lokalitetin e tyre dhe ne menyren e percaktuar nga ana e shteteve perkatese.

Neni 11

Rregullime me te detajuara mbi organizimin e kesaj shoqerie jane te percaktuara ne Statutin e saj.

Themeluesi pas leximit me kujdes te Aktit te Themelimit e nenshkruan si te sakte dhe ne perputhje me vullnetin e tij.

Emri dhe nenshkrimi i Ortaku Themelues:

ORTAKU THEMELUES

Xhovana Hasani

